



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Inline Engineering" të datës 26.05.2026 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.05.2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikes për IEA" me nr. të prokurimit 616-26-1531-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Inline Engineering" të datës 26.05.2026 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.05.2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikes për IEA" me nr. të prokurimit 616-26-1531-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Inline Engineering" (tutje "parashtruesi") me datë 26.05.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.05.2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikes për IEA" me nr. të prokurimit 616-26-1531-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

"I. GJENDJA FAKTIKE

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës, me datë 20.05.2026, ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK-së, me të cilin OE INLINE ENGINEERING SH.P.K është eliminuar nga procedura e prokurimit, ndërsa kontrata i është rekomanduar OE "ELEKTRIKA-MONT" SH.P.K.

Oferta jonë ka qenë ekonomikisht më e favorshme:

- INLINE ENGINEERING SH.P.K → 53,706.00 €
- OE i rekomanduar → 66,552.00 €

Përkundër kësaj, AK ka eliminuar OE tonë për arsye:

- administrative;
- formale;
- të sqarueshme;
- dhe pa ndikim substancial në ofertë.

II. SHKELJA E NENIT 72 TË LPP-SË

Autoriteti Kontraktues në asnjë moment:

- nuk ka kërkuar sqarime;
- nuk ka kërkuar plotësime;
- nuk ka kërkuar verifikime shtesë.

Ndërkohë të gjitha arsyet e eliminimit janë të natyrës administrative dhe plotësisht të sqarueshme.

Mosaplikimi i nenit 72 të LPP-së përbën:

- shkelje serioze procedurale;
- trajtim diskriminues;
- dhe devijim nga praktika standarde e prokurimit publik.

Praktika e OSHP-së vazhdimisht ka mbajtur qëndrim se:

- mungesa e ndonjë vule;
- mungesa e datës;
- mungesa e fotografive;
- mungesa e ndonjë informacioni administrativ;
- apo paqartësitë teknike të sqarueshme,

nuk duhet të rezultojnë me eliminim automatik pa iu dhënë OE-së mundësia për sqarim. OSHP në raportet dhe vendimet e saj ka theksuar se dokumentet administrative dhe marrëveshjet e shfrytëzimit mund të sqarohen për aq kohë sa identifikohet qartë:

- operatori ekonomik;
- aktiviteti i prokurimit;
- dhe pajisjet përkatëse.

Po ashtu, OSHP ka mbajtur qëndrim se operatori ekonomik duhet të ketë mundësi të kuptojë plotësisht arsyet e eliminimit në mënyrë që të mund të ushtrojë mjet juridik efektiv.

III. MARRËVESHJA ME OMEGA-I SH.P.K

AK pretendon:

“marrëveshja nuk ka vullë”.

Mirëpo dokumenti përmban:

- vullë;
- nënshkrime;
- datë;
- titullin e aktivitetit;
- numrin e prokurimit;
- identifikimin e pajisjeve.

Kjo dëshmon qartë se:

- dokumenti është valid;

- marrëveshja ekziston;
- dhe AK nuk e ka shqyrtuar dokumentacionin me kujdes profesional.

Ky vlerësim bie ndesh me:

- nenin 59 të LPP-së;
- praktikën e OSHP-së;
- dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

IV. MARRËVESHJA ME EL TEX GROUP SH.P.K

AK pretendon:

"marrëveshja nuk ka datë të fillimit".

Mirëpo marrëveshja përmban:

- vulat;
- nënshkrimet;
- titullin e aktivitetit;
- numrin e prokurimit;
- identifikimin e pajisjeve.

Secila marrëveshje posedon qartë:

- titullin e kontratës;
- numrin e prokurimit;
- dhe referencën e aktivitetit.

Prandaj është plotësisht e qartë dhe e padiskutueshme se marrëveshjet janë lidhur pikërisht për realizimin e kësaj kontrate.

Për më tepër, marrëveshjet përcaktojnë se:

"mjeti do të jetë në dispozicion të kompanisë INLINE ENGINEERING SH.P.K për afat të pacaktuar..."

Rrjedhimisht:

- data specifike nuk ka ndikim substancial;
- nuk ndikon në disponueshmërinë e pajisjeve;
- nuk ndikon në kapacitetin teknik;
- dhe nuk ndikon në ofertë.

Eliminimi për këtë arsye është:

- formalist;
- disproporcional;
- dhe në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së dhe praktikën e OSHP-së.

V. INTERPRETIM I GABUAR I KRITERIT TË "A-TESTIT"

Në DT është kërkuar:

"Kapacitet minimum 10m³, vinçi me hapje minimum 20m (të dëshmohet me atest OSE dokument që vërteton gjatësinë e kranit)"

OE ynë ka dorëzuar:

- dokument teknik/grafik të vinçit EFFER 36N/6S.

Pra kërkesa e DT-së është plotësuar.

AK:

- ka interpretuar kriterin në mënyrë të kundërligjshme;
- ka vendosur standard më të ashpër sesa ai i publikuar;
- dhe ka eliminuar OE-në në kundërshtim me vetë DT-në.

Kjo përbën:

- shkelje të nenit 59 të LPP-së;
- trajtim arbitrar;
- dhe dyshim serioz për favorizim.

VI. FOTO TË FURGONËVE DHE MANGËSI JO-SUBSTANCIALE

AK pretendon mungesë të fotografive të furgonëve.

Mirëpo:

- mjetet janë identifikuar me targa;
 - janë paraqitur në listën e pajisjeve;
- 7/1 5 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK

- ekzistojnë marrëveshjet e shfrytëzimit.

Fotografia:

- nuk vërteton pronësinë;
 nuk ndikon në kapacitetin teknik;
 dhe nuk përbën element substancial të ofertës.

Eliminimi për mungesë fotografie është:

- joproporcional;
 diskriminues;
 dhe në kundërshtim me praktikën e OSHP-së.

VII. REGJISTRIMI I MJETIT 01-227-OA

AK pretendon se regjistrimi ka qenë i skaduar.

Mirëpo:

- mjete ekziston;
 është identifikuar;
 është paraqitur në listën e pajisjeve;
 dhe është objekt marrëveshjeje shfrytëzimi.

Regjistrimi është dokument administrativ i rinovueshëm dhe nuk ndikon në ekzistencën reale të pajisjes.

Praktika e OSHP-së ka mbajtur qëndrim se:

- dokumentet e rinovueshme;
 apo mungesat administrative;

nuk duhet të përdoren si bazë automatike për eliminim.

VIII. LISTA E STAFIT

AK ka përdorur arsyetim:

"lista e stafit është gjysmake".

Mirëpo AK: 8/1 5 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

- nuk ka specifikuar cilët persona mungojnë;
- nuk ka identifikuar kriterin e paplotësuar;
- nuk ka treguar cilat dokumente mungojnë.

Një vendim administrativ duhet të jetë:

- konkret;
- i argumentuar;
- dhe i verifikueshëm.

Mungesa e arsytimit konkret përbën shkelje serioze procedurale dhe bie ndesh me praktikën e OSHP-së.

IX. SHKELJA E PARIMIT TË PROPORCIONALITETIT DHE DYSHIMET PËR FAVORIZIM

OE INLINE ENGINEERING SH.P.K është eliminuar:

- për mangësi administrative;
- për çështje të sqarueshme;
- dhe pa asnjë ndikim substancial në ofertë.

Ndërkohë:

- oferta jonë ka qenë ekonomikisht më e favorshme;
- AK nuk ka aplikuar nenin 72;
- dhe ka përdorur standard tepër formalist vetëm ndaj OE-së sonë.

Kjo krijon dyshime serioze për:

- trajtim selektiv;
- favorizim të OE të rekomanduar;
- dhe cenim të konkurrencës së lirë.

Veprimet e AK-së:

- bien ndesh me nenin 1 të LPP-së;
- bien ndesh me nenin 7 të LPP-së;
- cenojnë konkurrencën e drejtë;
- dhe dëmtojnë buxhetin publik duke eliminuar ofertën ekonomikisht më të favorshme me diferencë mbi 12,000 €.

X. KËRKESA

Duke u bazuar në:

- dokumentacionin e tenderit;
- dokumentet e dorëzuara nga OE ynë;
- dispozitat e LPP-së;
- praktikën e OSHP-së;
- dhe shkeljet procedurale të evidentuara,

KËRKOJMË nga Autoriteti Kontraktues që:

1. Të aprovojë kërkesën tonë për rishqyrtim si të bazuar;
2. Të anulojë vendimin për eliminimin e OE INLINE ENGINEERING SH.P.K;
3. Të anulojë rekomandimin për dhënie kontrate;
4. Të rikthejë ofertën tonë në rivlerësim;
5. Të aplikojë nenin 72 të LPP-së për çdo paqartësi eventuale;
6. Të zhvillojë procedurën në përputhje me LPP-në dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomik.

Në të kundërtën, OE ynë do të detyrohet të vazhdojë procedurat:

- pranë OSHP-së;
- KRPP-së;
- Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- dhe institucioneve kompetente për hetimin e keqpërdorimeve në prokurim publik.

OE I REKOMANDUAR PER KONTRAT I PAPERGJEGJSHEM :

Bazuar në nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues për rekomandimin e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, për shkak se i njëjti nuk i plotëson kriteret profesionale dhe teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, ndërsa AK gjatë procesit të vlerësimit ka bërë interpretim të kundërligjshëm të kriterëve dhe trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë.

I. SHKELJET E LIGJIT PËR PROKURIM PUBLIK

1. Shkelja e nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim / Mosdiskriminimi)

Autoriteti Kontraktues ka bërë trajtim jo të barabartë dhe jo transparent duke:

- pranuar certifikata trajnimi dhe pjesëmarrjeje si zëvendësim të "kualifikimeve shkollore";
- toleruar mungesën e dokumenteve obligative për OE të rekomanduar;

interpretuar kriteret në mënyrë të ndryshme pas hapjes së ofertave.

Nëse AK ka kërkuar "kualifikime shkollore", atëherë nuk mund të pranojë:

- trajnime afatshkurtra,
- seminare,
- apo certifikata pjesëmarrjeje,

si ekuivalente me:

- diplomë profesionale,
- arsim formal,
- apo shkollim teknik të akredituar.

Veprimi i tillë përbën:

- favorizim,
- cenim të konkurrencës së drejtë,
- dhe shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

2. Shkelja e nenit 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

AK ka qenë i obliguar që:

- të vlerësojë ofertat vetëm mbi bazën e kërkesave të dosjes së tenderit;
- të mos devijojë nga kriteret e vendosura;
- të mos bëjë interpretim të zgjeruar të dokumenteve.

Në këtë rast AK ka bërë:

- zbutje të kriterëve pas hapjes së ofertave;
- pranim të dokumenteve që nuk përputhen me kërkesat obligative;
- dhe vlerësim jo objektiv të ofertës së OE të rekomanduar.

3. Shkelja e nenit 60 të LPP-së (Kriteret për Dhënie të Kontratës)

OE i rekomanduar nuk mund të shpallet fitues kur:

- nuk i plotëson kriteret profesionale dhe teknike;
- nuk posedon dokumentacionin e kërkuar nga dosja e tenderit;
- dhe nuk e ka dëshmuar kapacitetin profesional sipas kërkesave obligative.

4. Shkelja e nenit 69 të LPP-së (Aftësia Teknike dhe Profesionale)

AK ka kërkuar qartë:

“Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme”.

Termi: “kualifikime shkollore” nënkupton:

- diplomë profesionale,
- arsim formal,
- shkollim teknik,
- apo kualifikim profesional të akredituar.

Ndërsa:

- certifikatat e pjesëmarrjes,
- trajnimet disa ditore,
- apo seminarët,

nuk përbëjnë kualifikim shkollor sipas kuptimit ligjor dhe profesional.

5. Shkelja e parimit të transparencës dhe interpretimit strikt të Dosjes së Tenderit

Praktika e vazhdueshme e OSHP-së përcakton se:

- kriteret e dosjes interpretohen në mënyrë strikte;
- AK nuk mund të ndryshojë kuptimin e kriterëve pas hapjes së ofertave;
- dhe dokumentet obligative duhet të ekzistojnë në momentin e ofertimit.

Në këtë rast AK ka bërë:

- interpretim arbitrar të kriterit;
- zëvendësim të “kualifikimit shkollor” me “trajnim”;
- dhe ka pranuar dokumente që nuk janë ekuivalente me kërkesën e dosjes së tenderit.

II. FAKTET DHE ANALIZA E DOKUMENTEVE TË OFRUARA NGA OE I REKOMANDUAR

1. Kërkesa e Dosjes së Tenderit

AK ka kërkuar: “Elektricitetë të certifikuar – 9 persona” por paraprakisht ka përcaktuar se: “personeli profesional duhet të ketë kualifikime shkollore”.

Pra:

- certifikimi është kërkesë shtesë,
- ndërsa baza mbetet kualifikimi shkollor formal.

12/ 15 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

2. Kandidatët që nuk e plotësojnë kriterin

a) Leotrim Hoxha

Për këtë kandidat është dorëzuar vetëm:

- "Certificate of Participation – Electricity Installation".

Nuk evidentohet:

- diplomë profesionale,
- shkollë profesionale,
- arsim teknik,
- apo kualifikim shkollor formal.

Prandaj kandidati nuk e plotëson kriterin.

b) Driton Hoxha

Është dorëzuar vetëm:

- certifikatë pjesëmarrjeje në trajnim.

Nuk ekziston:

- diplomë profesionale,
- arsim teknik formal,
- apo kualifikim shkollor.

Prandaj kandidati nuk e plotëson kriterin.

c) Mergim Sahitolli

Për këtë kandidat është ofruar vetëm:

- certifikatë trajnimi/pjesëmarrjeje.

Nuk evidentohet:

- diplomë profesionale,
- shkollim teknik,
- apo kualifikim shkollor.

Prandaj kandidati nuk e plotëson kriterin.

d) Meriton Sahitolli

Për këtë kandidat është dorëzuar vetëm:

certifikatë pjesëmarrjeje.

Nuk evidentohet:

- diplomë profesionale,*
- shkollim teknik,*
- apo kualifikim shkollor formal.*

Prandaj kandidati nuk e plotëson kriterin.

e) Labinot Dedushi

AK ka kërkuar: "Punëtor i certifikuar për Menaxhimin e Projekteve dhe Menaxhimin e Kantierit të Ndërtimit".

Për këtë kandidat:

- nuk evidentohet certifikim profesional për menaxhim projektesh;*
- nuk evidentohet certifikatë për menaxhim kantieri;*
- nuk evidentohet kualifikim formal për këtë pozitë.*

Është dorëzuar vetëm:

- kontratë pune/angazhim.*

Kontrata e punës nuk e zëvendëson certifikimin profesional të kërkuar nga AK.

Prandaj kandidati nuk e plotëson kriterin.

f) Inxhinieri për Auditim të Energjisë dhe ISO 50001:2018

AK ka kërkuar:

- trajnim/certifikim për Auditim të Energjisë në Ndërtesa dhe Ndriçim Publik;*
- Auditor standardi ISO 50001:2018.*

Nga dokumentacioni i dorëzuar:

- nuk evidentohet certifikata për Auditim të Energjisë;*
- nuk evidentohet certifikata ISO 50001:2018 Auditor.*

Prandaj OE i rekomanduar nuk e ka dëshmuar këtë kriter obligativ".

Lidhur me pretendimet ankimore duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina – Municipality of Pristina
SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT
KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

LETËR STANDARDE PËR TENDERUESIN E ELIMINUAR

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës për IEA.

Numri i aktivitetit të rokurimit
Nr i rokurimit 616-26-1531-1-2-1
Nr i brendshëm 616-26-028-1-2-1

Të nderuar/a
OPERATORI EKONOMIK: INLINE ENGINEERING SH.P.K., Bulevardi i Deshmorve Ulpian,
10000, Prishtinë, Kosovë

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP". *Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*
Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

1. Te lista e pajisjeve, marrveshja me OMEGA-I sh.p.k per huazim te pajisjeve nuk ka vulë,
2. Te marrveshja me El TEX Group sh.p.k nuk ka datë të nëshkrimit apo të fillimit të marveshjes për shfrytëzim të pajisjeve të huazuara.
3. Të gjithë Furgonat e paraqitur tek Oferta nuk kanë FOTO ashtu siq kërkohet tek DT
4. Lista e stafit, pjesa e numrave personal si infarmcion bazik është gjysmake
5. Për kamionin me kapacitet minimum 10m3, pajisja nuk ka A test.
6. Kamioni me kran 01-227-OA nuk ka regjistrin (i skaduar).
7. Te lista e pajisjeve disa nga pajisjet nuk e kanë paraqitur vitin e prodhimit

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,
Sektori i Prokurimit
Komuna e Prishtinës.

Adresa: Rr. UÇK 2, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 230 900, <http://www.pristina.rks-gov.net/>

Faqe 13 nga 14

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 02.06.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.